



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 23.04.2021

Nr: 285

VENDIM

PËR

**PLOTËSIMIN E VAKANCËS NË KËSHILLIN E BASHKISË LEZHË, ME
KANDIDATIN NGA LISTA SHUMEMËRORE E PARTISË SOCIALDEMOKRATE TË
SHQIPËRISË, Z. ALBAN ZEF BRUKA**

Në mbështetje të neneve 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreut V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, pasi shqyrtova dokumentacionin përkatës,

VËREJ:

Me shkresën nr. 5751 prot., datë 01.04.2021, këshilli i bashkisë Lezhë, ka njoftuar Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës nga këshilltari, zj. Dorina Afrim Gjini, propozuar nga partia Socialdemokrate e Shqipërisë.

Referuar nenit 164, pika 2 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” i ndryshuar, kandidati vijues nga lista shumemërore e partisë Socialdemokrate e Shqipërisë, për këshillin e bashkisë Lezhë, të cilit i kalon mandati i këshilltarit, është kandidati me numër rendor 07, z. Alban Zef Bruka.



Data: 23.04.2021

Nr. 285

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, z. Alban Zef Bruka.

Me shkresën nr. 3322 prot., datë 07.04.2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve i është drejtuar kandidatit për anëtar në këshillin e bashkisë Lezhë, z. Alban Zef Bruka, me kërkesë për plotësim dokumentacioni.

Referuar nenit 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, vetëdeklarimi dhe verifikimi i kushteve të të dhënave në përputhje me këtë ligj, kryhet për çdo kandidat të listës shumemërore për zgjedhjet pararendëse, për këshillin bashkiak, të cilit i takon të marrë mandatin e këshilltarit për vendin vakant.

Kandidati për këshilltar, përcaktuar në bazë të listës shumemërore, të subjektit partia Socialdemokrate e Shqipërisë, ka plotësuar e depozituar formularin e vetëdeklarimit, me numër 2153 unik, në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si organi kompetent për administrimin, verifikimin, zbatimin e ndalimeve për zgjedhjen dhe emërimin në funksionin publik, ku përfshihet dhe funksioni i këshilltarit të bashkisë.

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit, të kandidatit për anëtar, z. Alban Zef Bruka, në këshillin e bashkisë Lezhë, rezulton se, nuk ka deklaruar asnjë të dhënë që ka të bëjë me parashikimet për ndalime në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" dhe Kreut V, pika 2, shkronja “b” dhe pika 3, shkronja “c”, të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015”, me shkresën nr. 3721 prot., datë 12.04.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes civile dhe me shkresën nr. 3720 prot., datë 12.04.2021 ka kërkuar informacion nga zyra e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar, z. Alban Zef Bruka, në këshillin e bashkisë Lezhë, që ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, si dhe ka bërë publikimin e formularit të vetëdeklarimit në faqen zyrtare të internetit.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Civile, nuk i ka kthyer ende përgjigje kërkesës sonë, për verifikimin e të dhënave për kandidatin për anëtar në këshillin e bashkisë Lezhë, z. Alban Zef Bruka.

Drejtorja e Përgjithshme e Gjendjes Gjyqësore, me shkresën nr. 3999/1 prot., datë 19.04.2021, ka dërguar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve, verifikimin e gjendjes gjyqësore për kandidatin për anëtar z. Alban Zef Bruka, në këshillin e bashkisë Lezhë, i cili rezulton se nuk ka shënime në sistem.

Referuar pikës 2, të Kreut V, të vendimit nr. 17/2016 të Kuvendit konstatoj se, të dhënat e kandidatit për anëtar z. Alban Zef Bruka, në këshillin e bashkisë Lezhë, nuk përbëjnë kusht për moszgjedhjen e kandidatit në funksionin e këshilltarit.



PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2 dhe 164, pika 2 dhe 4, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nenin 11, të ligjit nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, Kreun V, të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, “Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”.

V E N D O S:

1. Z. Alban Zef Bruka, kandidat për anëtar në këshillin e bashkisë Lezhë, nuk përfshihet në kushtet e moszgjedhshmërisë për ushtrimin e funksionit.
2. Plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumemërore e partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, z. Alban Zef Bruka.
3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimimeve dhe Sanksioneve, brenda 3 (tre) ditëve nga hyrja e tij në fuqi.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

Ilirjan CELIBASHI



Data: 23.04.2021

Nr. 285

Për plotësimin e vakancës në këshillin e bashkisë Lezhë, me kandidatin nga lista shumemërore e Partisë Socialdemokrate të Shqipërisë, z. Alban Zef Bruka.